



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 14 Dt. 05.01.2024
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Në mbështetje të nenit 48 paragrafi 1 nënparagrafi f), nenit 48 paragrafi 2 nënparagrafi e), neni 49 paragrafi 1.1. nënparagrafi a) dhe nenit 49 paragrafi 1.2. nënparagrafi c) të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Komisioni Disiplinor i FBK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore mori këtë

V E N D I M

- I.** Dion Basha, trajner i KBF Peja 03 (U16 vajzat), për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: **Ndalesë në kryerje të detyrës për periudhë të caktuar kohore, prej gjashtë (6) muaj.**
- II.** Ergin Balaj, trajner i KBF Prishtina (U16 vajzat), për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: **Ndalesë në kryerje të detyrës për periudhë të caktuar kohore, prej gjashtë (6) muaj.**
- III.** Endrit Basha, drejtor i KBF Peja 03 (U16 vajzat), për shkelje të lehtë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: **Dënim me të holla, në lartësi prej 500.00 EUR.**
- IV.** Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Komisioni Disiplinor (këtu e tutje Komisione) nëpërmjet postës elektronike, më datën 05.12.2023, ka pranuar email nga sekretarja e përgjithshme, znj. Elvira Duhku, në të cilin ka gjetur të bashkëngjitur kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Dion dhe Endrit Basha dhe Ergin Balaj, të përfshirë në incidentin KBF Peja 03 – KBF Prishtina, Liga U16 Vajzat (xhiro VIII), sipas Informatorit Nr. 8 Liga U16 Vajzat Xhiroja VIII.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, Komisioni, më qëllim që menjëherë të fillojë me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 07.12.2023, në orën 17.00, në lokalet e FBK-së, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç' rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, Komisioni, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet shërbimeve të sekretarisë të FBK-së, për t'u njohur me variantin e ngjarjes apo të problemit, palëve të përfshira në konflikt t'u kërkohet që të deklarohen më shkrim.

Për qëllime të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 07.12.2023, Komisioni është takuar edhe më datën 19.12.2023. Në takime kanë qenë prezent: Fidan Hamiti - kryetar, Afrim Kamishi – anëtar, Omer Daku – anëtar, si dhe në përputhshmëri me nenin 36 të Rregullores Disiplinore, prezent kanë qenë edhe Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-së dhe Enea Hajdari, këshilltare ligjore për sport e FBK-së.

Më datën 14.12.2023, Komisioni, nëpërmjet email-it, nga shërbimet e sekretarisë të FBK-së, sipas kërkesës ka pranuar dy deklaratata të ndara, një nga Ergin Balaj, trajner i KBF Prishtina (U16 vajzat) dhe një tjetër nga Dion Basha, trajner i KBF Peja 03 (U16 vajzat).

Më qëllim që ta ruaj paanësinë dhe ta vlerësoj situatën në mënyrë sa më objektive, Komisioni ka marr për bazë edhe deklaratat e zyrtarëve të FBK-së të prezantuara në Informatorin Nr. 8 Liga U16 Vajzat Xhiroja VIII dhe raportin e delegates së ndeshjes përkatëse, i cili sipas evidencës së Komisionit është pranuar më datën 05.12.2023

Nga leximi i deklaratave shihet qartë se kemi të bëjmë me një konflikt, gjegjësisht përleshje fizike në kuadër të ngjarjes sportive, ku Dion Basha, trajner i KBF Peja 03 (U16 vajzat) dhe Ergin Balaj, trajner i KBF Prishtina (U16 vajzat) kanë sulmuar njëri - tjetrin. Në këtë kuadër, ndër të tjera, komisioni ka konfirmuar përfshirjen edhe të z. Endrit Basha, i cili vërehet se ka nxitur dhe provokuar z. Ergin Balajn, duke fyer, duke bërë gjeste dhe duke reaguar në mënyrë jo sportive. Marrë parasysh që e gjithë ngjarja ka ndodhur në kuadër të një ndeshje ku për nga natyra shkeljet e supozuara janë të njëjta, komisioni ka trajtuar çështjen në kuadër të një lënde.

Gjatë shqyrtimit të deklaratave, të cilat janë pjesë e dosjes së lëndës përkatëse, Komisioni ka gjetur prova të mjaftueshme të cilat e konfirmojnë se ka pasur realizim të sulmit fizik ndërmjet trajnerëve Ergin Balaj dhe Dion Basha, përderisa ka pasur fyerje, provokime dhe nxitje nga z. Endrit Bashën, drejtor i KBF Peja 03. Të gjitha këto janë konfirmuar nga komisar i garave për kategoritë e reja, z. Xhelal Mumini, të artikuluar në Informatorin Nr. 8 Liga U16 Vajzat Xhiroja VIII (teksti pa ndërhyrje); *"KBF PEJA 03 – KBF PRISHTINA Liga U16 Vajzat xhiroja VIII – Pas përfundimit të ndeshjes, bazuar në raportet e personave zyrtare të ndeshjes, dyshes së gjyqtarëve*

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

dhe vëzhgueses, ka pasur realizim të sulmit fizik ndërmjet trajnerëve (Dion Basha dhe Ergin Balaj) si dhe personit (Endrit Basha). "Shto Dispozitivin e Informatori".

Realizimi i sulmit fizik është konfirmuar edhe nga znj. Ariana Sylejmani, delegate e ndeshjes e cila atë e ka konfirmuar me anë të email-t të dërguar më datën 26.11.2023, në orën 11.12, ku ndër të tjera thuhet (teksti pa ndërhyrje): *"Perserisa Dion Basha, Endrit Basha dhe Ergin Balaj fillojnë të largohen nga salla, ne largim e sipër Dion Basha trajner i KBF Peja 03 ia vendos doren mbas qafe trajnerit Ergin Bales dhe ai ne zemërim e sipër iu hudh sendet që i kishte në dorë fytyrës Dion Bashes dhe Endrit Bashes. Pas këtij momenti filloj edhe sulmi fizik ku të pranishmit hyn në parket i largojn Endrit Basha dhe Dion Basha jashtë fushes, procesmbajtësi me vrap lajmroj referet dhe referet u kthyen duke vrapuar në sallë, referet u munduan ta qetesojn trajnerin Ergin Balaj ku ai, duke vrapuar shkoj drejt trajnerit Dion Basha dhe filluan prap sulmi fizik në mes të Ergin Balaj, Dion Basha dhe Endrit Basha, referet i ndajten perseri."*

Se ka pasur sulm fizik, kjo është konfirmuar edhe përmes deklaratave të dy trajnerëve përfaqësues të ekipeve përkatëse.

Për efekt të konfirmimit, Komisioni ka shkëputur dy paragrafë, nga deklarata e z. Dion Basha (teksti pa ndërhyrje): *"Pas perfundimit të ndeshjes, vellau im, E. Basha, u afrua tek tavolina zyrtare dhe i tha trajnerit Bala që të lutem mos i provoko vajzat në këtë mënyrë se nuk i ka hije një trajnerit të sillet në këtë mënyrë me vajza të moshave që te vogla dhe trajneri Bala i është përgjigjur në mënyrë ofenduese që une provokoj sa here të dua, (realisht ka përdorur term tjetër por për hir të respektit nuk dua të përdor fjalët që ka thënë ai)."*

Duke marrë parasysh paragrafin e mesiperm, duke e pa situatën të cilën kishte synim ta shkaktonte trajneri Bala, pa fajin tim dhe rrezikun që po me kanosej me jete, une kam nderhy me ndale sulmin, pra e kam mbrojtur veten. Trajnerin Bala nuk mund ta ndalonin as dhjetëra persona të cilët ishin në sallë, ai provonte që me një marker të me godiste në sy, ku për pasojë e kam pasur shikimin e mjegulluar që 3 javë".

Dhe, dy paragrafë të tjerë nga deklarata e Ergin Balajt (teksti pa ndërhyrje): *"Unë shkova tek tavolina zyrtare për të fotografuar procesin e ndeshjes. Atje, Endrit Basha më afrohet dhe duke thënë me një zë kërcënues: "le të kjo hera e fundit që provokon në Pejë". Unë ja ktheva: "Per qka e ki Endrit qfare provokimi", dhe ai me fjalët e njëjta*

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

por me intensitet më të lartë thotë prapë: "une po tthom mos provoko mo kurre nPeje". Unë ja ktheva: "une se provokoj kerkon Endrit nese e ke marr provokim, e hongsh me tshnosh".

"Tamon afrohet Endrit, në ato çaste vjen Dion Basha dhe më sulmon. Nga ai moment, unë po bëja përpjekje të mbrohesh nga sulmi i dy vëllezërve. Cdo veprim i imi ishte në vetmbrojtje dhe ishte pas sulmit që më bëri Dion Basha. Kjo përleshje vazhdoi deri sa erdhën pjesëtarë të tavolinës zyrtare për të ndërhyrë."

Nga të gjitha këto deklarata dhe prova shkresore, Komisioni ka vërejtur se përfshirje në sulm të drejtpërdrejt ka pasur nga Dion Basha dhe Ergin Balaj, përderisa në mënyrë të tërthortë eskalimit të situatës në formë të provokimit dhe nxitjes i ka kontribuar personi i tretë, Endrit Basha, i cili nga të dhënat e siguruar nga Komisioni Disiplinor, konfirmohet se ai ushtron detyrën e drejtorit të Klubit KBF Peja 03.


Në kuptim të komisionit, lënda e të përfshirëve është trajtuar duke e vërë theksin në kryerjen e shkeljes dhe matjen e dënimit nga kryerësit përkitazi me Rregulloren Disiplinore dhe jo në gjetjen e fajtorit, meqë nga ajo që është vërtetuar rasti është duke u trajtuar në polici.

Komisioni e ka cilësuar sjelljen e të përfshirëve në sulm si tepër dekurajuese, sidomos shembullin e keq që të përmendurit kanë sjellë tek gjeneratat e reja të cilat për nga rëndësia bëjnë pjesë në prioritetet e FBK-së, si dhe si të tilla trajtohen me ndjeshmëri.

Komisioni ka analizuar provat shkresor, përfshirë këtu edhe deklarata e të përmendurve, ka ndërlidhur ato në mes veti, si dhe ka krahasuar me dispozitat e Rregullores për Procedurat Disiplinore të FBK-së dhe ka ardhur në përfundim se, z. Dion Basha dhe Ergin Bala, si rezultat i përleshjes fizike kanë kryer veprime të cilat konsiderohen si shkelje të rënda disiplinore, përderisa si rezultat i provokimit dhe nxitjes së situatës, Endrit Basha, drejtor i KBF Peja 03, ka kryer veprime të cilat konsiderohen si shkelje të lehta disiplinore.

Komisioni, si rezultat i pranimit të fajësisë dhe shprehjes së keqardhjes nga të përmendurit dhe duke marrë për bazë kontributin e tyre ndër vite në zhvillim të basketbollit në matje dhe shqiptim të dënimit ka aplikuar rrethanat lehtësuese.

Andaj duke u mbështetur në atë që i tha më lart, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

KOMISIONI DISIPLINOR :


Omer Daku, anëtar
Fidan Hamiti, kryetar
Afrim Kamishi, anëtar

Prishtinë, 05.01.2024



Vendimi t'u dërgohet:

- Dion Bashës,
- Ergin Balajt,
- Endrit Bashës,
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së dhe
- Arkivit të FBK-së.

KËSHILLË JURIDIKE:

Konform Nenit 42 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrahet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Arbitrazhit të FBK-së. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

